



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0993**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Aritech” kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "615-23-4097-5-5-8" të Komunës së Podujevës, më 15/03/2024 mori këtë:

## **Vendim**

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Aritech” me nr. 2023/993, e datës 08/12/2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "615-23-4097-5-5-8" iniciuar nga autoriteti kontraktues, Komuna e Podujevës.
2. Mbetet në fuqi “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” dt.23.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit i përshkruar si në piken I të dispozitivit të këtij vendimi.
3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative”. Ndërsa me datën 23/11/2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “Botek Sh.P.K”.

Me 27/11/2023, OE “Aritech” ka parashtuar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 30/11/2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08/12/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Aritech” me nr. 993/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "615-23-4097-5-5-8”.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Përgjigja e Autoriteti kontraktues, ndaj Kërkesës për rishqyrtim të OE ankues.*

Përgjigja lidhur me pretendimin 1: Refuzohet si i pa bazuar pretendimi ankimor sepse OE "Botek" SH.P.K. i propozuar për kontratë ka vazhduar validitetin e ofertës vullnetarisht ku këtë fakt e dëshmon edhe teksti i bashkangjitur nga ana juaj Shih Printscreen 1 ku ceket: Ne si OE, nuk kemi pranuar nga AK kërkesën për vazhdimin e validitetit mirëpo ne mënyrë që te kemi ofertën tonë valide, duke synuar që të jemi në harmoni me dispozitat ligjore, ne në mënyrë vullnetare deklarojmë: Përgjigja lidhur me pretendimin II: Refuzohet si i pa bazuar pretendimi ankimor sepse AK me datë: 25.10.2023 ju është drejtuar të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet që të vazhdojnë vlefshmërinë e tenderit për 60 ditë dhe sigurimin e tenderit për 30 ditë, duke pas parasysh që AK është zgjatur për shkak të mungesës së mjeteve andaj në momentin që janë siguruar mjetet ka vazhduar me procedurën, dhe OE i propozuar për dhënie ka pas validitet dhe sigurim dhe çmimin më të ulët në mesin e OE pjesëmarrës andaj duke u bazuar në kronologjinë e lëndës nuk ka ndonjë shkelje në rastin konkret.”

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Aritech” janë parashtruar si në vijim:*

Sqarim Hyrës : “Ne me date 23.11.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ne njoftimin mbi vendimin AK ka vendosur te shpërbleje me kontrate OE Botek Shpk. Ne vijim do te paraqesim një kronologji te tenderit ne fjale: Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedure përmes mini tenderëve duke dërguar ftese për oferte me date 26.04.2023 për kontratën kornize e cila është realizuar ne kuadër te AQP-se. Dorëzimi i ofertës ka qene me date 06.06.2023, ne këtë aktivitet kane marr pjese gjithsej 5 ofertues. Përveç kërkesave tjera ne dosje te tenderit është kërkuar qe validiteti i tenderit te jete 60 dite kalendarike, po ashtu është kërkuar qe sigurimi i tenderit ne vlere 6000 euro për një periudhe te vlefshmërisë te jete 60 dite. Autoriteti kontraktues gjate kësaj periudhe 60 dhiteshe nuk ka bere asnjë veprim, por jo vetëm brenda kësaj periudhe por edhe për 80 dite te tjera nuk ka pas ndonjë veprim. AK me Veprim (mosveprim) te tille i vendos ne pozite te pabarabarte operatoret ekonomik. Duke analizuar ofertën e OE Botek ShPK kemi hasur ne dokumente me te cilat është vazhduar validiteti i ofertës dhe sigurimit te tenderit.

Pretendimi i parë (I): “Në ankesën janë te bashkangjitura Konfirmimet për vazhdimet te validitetit te ofertave. Botek ShPK ka dërguar vazhdimin e validitetit dhe sigurimit te tenderit me datat e lartcekura. Pra nga këto vërehet qarte qe AK ne kordinim me OE Botek ka pranuar zgjatje te validitetit te ofertës vetëm nga ky OE , pa kërkuar një gjë te tille nga OE-te e tjerë pjesëmarrës ne këtë aktivitet se paku jo nga Aritech Shpk. Për me tepër ky veprim i AK-se ka bere qe se paku OE Aritech Shpk (por jo vetëm) te këtë oferta te pavlefshme (pa mbuluar me sigurim dhe vlefshmëri) dhe për te arsyetuar veprimin me date 25.10.2023 përmes e-mailit kërkon zgjatjen e validitetit te tenderit dhe sigurimit te tenderit. 8/7 Printscreen nga E-mail, i dërguar nga AK- Komuna e Podujevës Pra nga ky veprim lind pyetja: ``Pse OE Botek ne mënyrë te njëanshme ka zgjatur validitetin? - Nëse këtë e ka bere pa i kërkuar AK pra “pa koordinim me AK”, pse AK nuk ka kërkuar zgjatjen e validitetit edhe për ofertat e tjera por një gjë te tille e ka bere me një vonese prej 80 dite nga dita e skadimit te vlefshmërisë te gjitha ofertave te OE-te tjerë? – A ndodh qe AK ka kërkuar zgjatjen e validitetit vetëm nga OE Botek (përmes tel, e-mail) dhe jo për te tjerët? Pra edhe një here po potencojmë qe AK s’ka bere asnjë veprim (kërkesë) ne e-prokurim, asnjë kërkesë drejtuar nga AK përmes e-mail deri me date 25.10.2023. Me te pranuar kërkesën ne si operator ekonomik ne përgjigje kemi sqaruar si ne vijim: Përgjigja me e-mail ne vijim ”Përshëndetje, Lidhur me

kërkesën tuaj, ju përkujtojmë që nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit dhe sigurimit të tenderit në mënyrë retroaktive. Mund të shihni me poshtë sqarimin nga KRPP: 9/7 7. 22.11.2022 Periudha e validitetit të ofertës ka skaduar derisa lënda ka qenë në shqyrtim në OSHP dhe aktiviteti i prokurimit ka qenë në pezullim. A mund të nënshkruhet një kontratë publike pa validitet të ofertës? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: “30.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshojë varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës”. Neni 30.4 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: “30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)”. “30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre”. Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohej zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkesë për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri të dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik. AK me datë 30.11.2023 e Refuzon kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar. Në sqarimet e saj thotë që OE Botek shpk e zgjatë validitetin e ofertës dhe të sigurimit të tenderit në mënyrë vullnetare. AK po ashtu konfirmon që me datë 25.10.2023 ka kërkuar zgjatjen e validitetit dhe sigurimit. Kërkesa e tillë për zgjatje të validitetit dhe sigurimit është retroaktive ( E pamundur nga OE të dërgohet zgjatja e validitetit dhe sigurimit në mënyrë retroaktive. 10/7 Vazhdimi prej asaj date (25.10.2023) është i pavlefshëm sepse nuk mbulohet nga data e skadimit të validitetit dhe sigurimit të tenderit. AK nëse do të kishte interesim për të proceduar me këtë aktivitetet të prokurimit do duhej të zbatonte Nenin 30.4 të rregullores për prokurim publik. Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i prokurimit të marrë masa ndaj Zyrtarit të prokurimit për moszbatim të Nenit 30.4 siç klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të rregullores për prokurim publik. Lidhur me përgjigjen e AK-se, ne e kundërshtojmë me sqarimin e KRPP-se: Citojmë: Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë

autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik. Rregullorja është e qarte, nuk i është lënë OE-ve në mënyrë vullnetare të zgjasin apo jo validitetin dhe sigurimin e tenderit. Kjo nuk është bere nga Autoriteti kontraktues, prandaj konsiderojmë qe ky aktivitet i prokurimit duhet te anulohet.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Aritech” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 7 të LPP-së . Duke u bazuar në argumentet me lartë kërkojmë nga Organi juaj shqyrtues qe te merr vendim si ne vijim: Vendim të Aprovohet si e bazuar Ankesa e OE “Aritech Shpk” lidhur me tenderin “Furnizim me pajisje te teknologjisë informative” me nr. prokurimi 615234090558. Anulohet Njoftimi mbi vendimin e AK-se nga “Komuna e Podujevës”, për shkak te mos ndjekjes se procedurave te përcaktuara sipas LPP-se. AK-së, të i kërkohej që te veproje sipas LPP-se dhe udhëzimeve te qarta ne RRUOP. Lidhur me mosveprim sipas rregullores, mosveprim sipas sqarimeve nga KRPP dhe LPP -se , te merren masa ndaj Zyrtarit te prokurimit, pasi qe mosveprimi sipas rregullores paraqet shkelje te rende sipas RRUOP nga ana e Autoritetit Kontraktues.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11/12/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 993/23, ndërsa me datë 15.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 993/23 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar për arsye të cilat u sqaron si më lartë, ndërsa AK të vazhdojë tutje me aktivitetin e prokurimit.

*Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0993, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;*

Konstatimi i parë (I): “Ekspertja shqyrtuese bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimi, shkresat e lëndës, pretendimet e ankuesit, dokumentet në platformën e-prokurimit, vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 30.11.2023, si dhe vazhdimin e validitetit dhe sigurimin e ofertës nga operatori ekonomik “Botek” shpk, vlerëson se ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, ku si pasojë e neglizhencës dhe papërgjegjësisë së autoritetit kontraktues, pësojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës të cilët kanë shprehur interesim për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP-së që është organ rregullativ dhe i vetmi i cili bënë interpretimin e dispozitave të LPP-së, si dhe interpretimin për çdo dokument që nxirret nga KRPP, që në rastin konkret “Rregulloren nr.001/2022 për Prokurimin Publik” është dokument i nxjerr nga KRPP, ekspertja sqaron se tek interpretimi me nr. 7 i datës 22.11.2022 është dhënë sqarimi si më poshtë: Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: “30.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës”. Neni 30.4 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: “30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)” “30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre”. Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohej zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin

Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkesë për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri të dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkojë zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.”

Konstatimi i dytë (II): “Ekspertja shqyrtuese sqaron se vazhdimi i validitetit dhe sigurimit të tenderit është bërë në mënyrë vullnetare nga operatori ekonomik “Botek” Sh.p.k, -Prishtinë, ku edhe ceket tek konfirmi për vazhdim të validitetit të ofertës “ne si OE nuk kemi pranuar nga AK kërkesën për vazhdim, mirëpo në mënyrë që të kemi ofertën tonë valide duke synuar të jemi në harmoni me dispozitat ligjore në mënyrë vullnetare deklarojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës”.

Konstatimi i tretë (III): “Ekspertja shqyrtuese vlerëson se autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës nuk ka vepruar sipas nenit 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku kjo dispozitë ligjore e obligon shprehimisht zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të kërkojë zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave para skadimit të afatit. Në rastin konkret, validiteti i tenderëve dhe sigurimi i tenderit ka qenë për një periudhë prej 60 ditë (06.06.23-06-08-2023), ndërsa AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim deri me datë 25.10.2023, kur i është drejtuar operatorëve ekonomik me kërkesë për zgjatje të validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit. Pra nga afati i fundit i validitetit të ofertave kanë kaluar afro 80 ditëve, që nënkupton me vonesë afro 80 ditë. Prej të gjithë OE pjesëmarrës, vetëm operatori ekonomik “Botek” Sh.p.k, (i rekomanduar) ka vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit me vetë iniciativë, që do të thotë se shkelja procedurale është shkaktuar nga vet AK. Në aspektin ligjor dhe sipas interpretimit të KRPP-së, si dhe sipas nenit 30.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, kërkohet që oferta të ketë validitet deri të dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, ndërsa KRPP bazuar në interpretimin numër 7. 22.11.2022, konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës dhe për këtë arsye, KRPP e mban përgjegjës zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të ketë kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Po ashtu, në interpretimin e KRPP-së jepen sqarime se në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkojë zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit sikurse në rastin konkret.”

Konstatimi i katërt (IV): “Ekspertja shqyrtuese konsideron se arsyetimi i AK-së se “kjo procedurë ka ngecë deri më tani në mungesë të mjeteve buxhetore” është arsyetim i paqëndrueshëm për shkak se AK me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit duhet që në pajtueshmëri me nenin 9, par. 5 të LPP-së, duhet që të përdorë formularin standard B04 “Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve (DNPDP)” të përgatitur dhe miratuar nga KRPP për vlerësimin e nevojave dhe konstatimin e disponueshmërisë së fondeve, kurse aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të konfirmohet me nënshkrim të DNPDP nga ZKA dhe ZKF. Për më tepër, edhe sikur të kishte mungesë të fondeve, kërkesa nga OE për zgjatje të validitetit të ofertave dhe sigurim të tenderit është kërkesë formale, e cila është përcaktuar në ligj dhe nuk mund të jepen arsyeime që në mungesë të fondeve të mos kryhet një veprim procedural, i përcaktuar në nenin 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku kjo

dispozitë ligjore e obligon shprehimisht zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të kërkoj zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave para skadimit të afatit. Sa i përket ankesës së OE ankues, ekspertja konsideron se duhet të trajtohet si e bazuar për arsye se për shkak të gabimeve të autoritetit kontraktues, janë penalizuar operatorët ekonomik, sepse mos kërkesa e AK-së me kohë për zgjatje të validitetit të ofertës nuk ka ndodhur për shkak të veprimeve të operatorëve ekonomik por për shkak të vet neglizhencës së AK-së. Kjo neglizhencë e AK-së penalizon operatorët tjerë ekonomik të cilëve ju ka skaduar afati i validitetit. Sa i përket kërkesës së OE ankues lidhur me nenin 97 të Rregullores Nr. 001/2022, ekspertja shqyrtuese sqaron se Autoritetit kontraktues është përgjegjës që të ndërmarr veprime në kuptime të nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Po ashtu mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97.1 pika f) të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet: “f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve”. Andaj, kërkesa e OE ankues është e bazuar. Sa i përket pretendimit të ankues, se rregullorja është e qartë dhe nuk i lenë OE-ve në mënyrë vullnetare të zgjasin validitetin dhe sigurimin e tenderit. Ekspertja shqyrtuese sqaron ashtu siç u cek edhe me lartë neni 30.4 i Rregullores Nr. 001/2022 obligon zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të kërkoj zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave para skadimit të afatit, por nuk ndalon askund vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderit nga operatorët ekonomik. Provë: Konfirmimet për vazhdim të validitetit të ofertës dhe sigurimi i tenderit nga operatori ekonomik “Botek” Sh.P.K, si dhe Kërkesa për zgjatjen të validitetit të ofertës dhe sigurimi të tenderit nga AK-Komuna e Podujevës e datës 25.10.2023.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon paneli shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar për arsyet të cilat u sqaruan në këtë raport, ndërsa autoriteti kontraktues të vazhdoj tutje /ta mbajt në fuqi njoftimin e datës 23.11.2023.”Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE nuk pajtohet rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

#### *- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit, ndërsa raporti i ekspertit shqyrtues pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si pjesërisht bazuara me rekomandimin që Autoriteti kontraktues të vazhdojë me aktivitet të prokurimit. Ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, për me tepër AK nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit dhe sigurimin e tenderit, por megjithatë OE ankuesi (me të dhëna të cekura si më lartë) në mënyrë vullnetare ka vazhduar validitetin e ofertës.

Paneli shqyrtues sqaron se arsyetimi i AK-së se “kjo procedurë ka ngecë deri më tani në mungesë të mjeteve buxhetore” është i paqëndrueshëm për shkak se AK me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit duhet që në pajtueshmëri me nenin 9, par. 5 të LPP-së, dhe duhet që të përdorë formularin standard B04 “Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve (DNPDP)” të përgatitur dhe miratuar nga KRPP për vlerësimin e nevojave dhe konstatimin e disponueshmërisë së fondeve, kurse aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të konfirmohet me nënshkrim të DNPDP nga ZKA dhe ZKF. Për më tepër, edhe sikur të kishte mungesë të fondeve, kërkesa nga OE për zgjatje të validitetit të ofertave dhe sigurim të tenderit është kërkesë formale, e cila është përcaktuar në ligj dhe nuk mund të jepen arsye të mos kryhet një veprim procedural.

Paneli shqyrtues po ashtu konstaton se kjo shkelje procedurale e ligjit nga ana e Autoritetit kontraktues, nuk ka pasur ndonjë efekt që ka dëmtuar operatorin ekonomik ankues, por as ndaj të gjithë operatorëve ekonomik ofertues, pa dallim, andaj dhe kërkesa e AK drejtuar OE me vonese për vazhdim të validitetit të ofertës, nuk ka pasur ndonjë favorizim apo ndikim në rezultatet e vlerësimit të ofertave, përkatësisht të përzgjedhjes së operatorit ekonomik të rekomanduar i përgjegjshëm administrativisht dhe me çmim me të ulët. Paneli shqyrtues konstaton se kjo shkelje procedurale nga ana e zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka dëmtuar vetë Autoritetin kontraktues, i cili nuk ka mund ta përfundojë këtë aktivitet të prokurimit me kohë, për shkak të ankese se paraqitur nga OE ankues, andaj zyrtari prokurimit duhet të jete i vëmendshëm dhe të mos përsërit shkeljet ligjore të konstatuara, në të kundërtën do të mund të iniciohen procedurat ligjore për marrje të licencës në autoritetin përkatës.

Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit, ngase tek përshkrimi i çmimit vërehet se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej 171,010.00 euro, derisa OE ankues ka ofertuar me çmim prej 177,761.50 euro, dhe kemi një ndryshim që i kontribuon pikërisht këtij parimi ekonomik në shfrytëzimin e buxhetit të institucionit. Andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik Aritech” dhe të mbetet në fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” lidhur me aktivitetin e prokurimit, “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informatike” me nr. të prokurimit: "615-23-4097-5-5-8" iniciuar nga autoriteti kontraktues, Komuna e Podujevës

Paneli shqyrtues sa i përket kërkesës së OE ankues lidhur me nenin 97 të Rregullores Nr. 001/2022, sqaron se Autoritetit kontraktues është përgjegjës që të ndërmarr veprime në kuptime të nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97.1 pika f) të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet: “f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve”.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: “Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për

vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: